




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 247/2019

Datë: 12 dhjetor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, nenit 33 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 3 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në mbledhjen e 227- të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Caktohen gjyqtarët mbikëqyrës si anëtarë të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës për vitin 2020.
- II. Anëtarë të Asamblesë nga radhët e gjyqtarëve mbikëqyrës për vitin 2020 caktohen:
 - Për Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Lipjan;
 - Për Gjykatën Themelore në Gjiilan, gjyqtari mbikëqyrës dega në Viti;
 - Për Gjykatën Themelore në Prizren, gjyqtari mbikëqyrës dega në Dragash;
 - Për Gjykatën Themelore në Mitrovicë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Zubin Potok;
 - Për Gjykatën Themelore në Gjakovë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Rahovec;
 - Për Gjykatën Themelore në Pejë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Istog;
 - Për Gjykatën Themelore në Ferizaj, gjyqtari mbikëqyrës dega në Shtërpçë.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.


A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, bazuar në nenin 3 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 07/2017 për Organizimin dhe Funksionimin e Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës, në të cilën parashihet që çdo vit të caktohen gjyqtar të ndryshëm mbikëqyrës nga rajoni i çdo gjykate themelore sipas rendit alfabetik të degëve të secilës gjykatë, në takimin e mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, caktoi gjyqtarët mbikëqyrës si anëtarë të Asamblesë: për Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Lipjan, për Gjykatën Themelore në Gjiilan, gjyqtari mbikëqyrës dega në Viti, për Gjykatën Themelore në Prizren, gjyqtari mbikëqyrës dega në Dragash, për Gjykatën Themelore në Mitrovicë, gjyqtari mbikëqyrës dega

në Zubin Potok, për Gjykatën Themelore në Gjakovë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Rahovec, për Gjykatën Themelore në Pejë, gjyqtari mbikëqyrës dega në Istog, si dhe për Gjykatën Themelore në Ferizaj, gjyqtari mbikëqyrës dega në Shtërpçë.

Gjyqtarët Mbikëqyrës nga rajonet e çdo gjykate themelore, të caktuar si më lartë, caktohen si anëtarë të Asamblesë për vitin 2020.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Kryetarit të Asamblesë së Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës;
- Kryetarëve të Gjykatave;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Lipjan;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Viti;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Dragash;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Zubin Potok;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Rahovec;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Istog;
- Gjyqtarit mbikëqyrës dega në Shtërpçë.
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.